

RAPORT MUJOR I FONDIT TË PENSIONIT PRIVAT “SMART PENSION”

Janar 2026

Emërtimi i Fondit: Fondi i Pensionit Privat me pjesëmarrje të hapur, Smart Pension (“Fondi”)

Shoqëria Administruese: Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, Albsig Invest sh.a.

Monedha Bazë: Lekë

Politika e Investimit: Fondi ka një tolerancë të ulët rreziku (konservator) duke respektuar parimin e sigurisë, diversifikimit dhe mbajtjes së likuiditetit të përshtatshëm për investimet afatgjata. Fondi do të investojë kryesisht në tituj borxhi (obligacione) afatgjatë të emetuar ose të garantuar nga qeveria e Republikës së Shqipërisë. Objektivi i investimit është rritja e të ardhurave duke ruajtur principalin dhe horizonti i investimit është afatgjatë.

PROFILI I RREZIKUT DHE PËRFITIMIT

RREZIK I ULËT

Përfitime zakonisht të ulëta

RREZIK I LARTË

Përfitime zakonisht të larta

1	2	3	4	5	6	7
----------	----------	----------	----------	----------	----------	----------

Fondi bie në kategorinë e parë të profilit të rrezikut, e cila është kategoria me rrezikut më të ulët. Kategoria e rrezikut përbën një rrezik sintetik i cili llogaritet duke u bazuar në luhatshmërinë e Fondit. Luhatshmëria e lartë ka një indikator rreziku më të lartë dhe një luhatshmëri më e ulët ka një indikator rreziku më të ulët.

Të dhënat kryesore për Fondin më 31.01.2026

Vlera Neto e Aktiveve :	145.525.083,29 ALL
Çmimi për kuotë:	1.163,3985 ALL
*Kthimi nga Investimit (31 JANAR 2025 - 31 JANAR 2026):	5.06%

**Tarifa e administrimit dhe tarifat e tjera zbriten përpara llogaritjes së kthimit nga investimi.*


KOSTOT DHE TARIFAT

- Komisioni vjetor i administrimit do jetë 1.2% në vit e vlerës neto të aktiveve të Fondit.
- Komisioni vjetor i auditimit të Fondit është sipas kushteve të punës të palëve ndërmjetësuese.
- Komisioni i depozitarit të Fondit
- Tarifa e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare(AMF) do jetë 0.05% në vit e vlerës së aktiveve të Fondit..
- Komisionet e transaksioneve me titujt në emër të Fondit.

Kostoja totale që do t’i mbahet Fondit nuk mund të kalojë në asnjë rast 1.5% të vlerës neto të aktiveve të Fondit.

SHPËRNDARJA E AKTIVEVE

Kategoria e Aktiveve	Vlera (në lekë)	% ndaj Aktiveve
Tituj të emetuar dhe garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.	138,651,797.03	95.28
Llogari rrjedhëse dhe depozita në banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë.	6,873,286.27	4.72

ECURIA E ÇMIMIT PËR KUOTË DHE PERFORMANCA E FONDIT.


Kthimi vjetorë neto rezulton 5.06% për periudhën 31 Janar 2025 - 31 Janar 2026.

Më poshtë shfaqen kthimet vjetore të Fondit për periudhat 1 vjeçare dhe 2 vjeçare deri më 31 Janar 2026.

Performanca e kaluar nuk duhet të përdoret si udhëzues për performancën në të ardhmen.

Fondi ka filluar aktivitetin në **12.01.2023**.

Smart Pension	5Y	3Y	2Y	1Y
	-	5.16	5.29%	5.06%
Norma Vjetore e Kthimit				